



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-CA-2022-01

**Vendosi:** **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**  
Gjykatëse Mishelë Pikar  
Gjykatës Kai Ambos  
Gjykatëse Nina Jorgensen

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 5 korrik 2022

**Gjuha e origjinalit:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën e Gucatit për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për  
Ridorëzimin e Njoftimit për Apel**

---

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hysni Gucatit:**  
Xhonatan Elistan Ris

**Mbrojtësit të Nasim Haradinajt:**  
Tobi Kadman

**PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT** të Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”<sup>1</sup> ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”), duke vepruar në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullës 172 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja”) ka marrë në shqyrtim kërkesën e parashtruar më 3 korrik 2022 nga Hysni Gucati (“Gucati”).<sup>2</sup>

1. Gucati kërkon shtimin me 151 fjalë të numrit të lejuar të fjalëve për njoftimin e tij për apel kundër Aktgjykimit, për të përfshirë përmbajtjen e Pikave 7, 23, 24 dhe 25 të Njoftimit të Haradinajt për Apel dhe për ridorëzimin e tij.<sup>3</sup> Gucati dorëzoi njoftimin për apel më 17 qershor 2022.<sup>4</sup> Në Pikën 18 të njoftimit të tij për apel, Gucati “i bashkohet pikave të përcaktuara” në Njoftimin e Haradinajt për Apel dhe përfshin “konkretisht” Pikat 7, 23, 24 dhe 25 të tij.<sup>5</sup> Më 1 korrik 2022, Paneli urdhëroi, *ndër të tjera*, se nëse Gucati dëshiron të mbajë përmbajtjen e Pikës 18, ai duhet të ridorëzojë njoftimin e vet për apel pa përfshirë në mënyrë të përgjithshme argumentet e parashtruara diku tjetër, jo më vonë se shtatë ditë nga marrja e Vendimit për Ridorëzimin e Njoftimeve për Apel.<sup>6</sup>

---

<sup>1</sup> F00011, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 21 qershor 2022.

<sup>2</sup> F00022, Kërkesë e Gucatit për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Ridorëzimin e Njoftimit për Apel, 3 korrik 2022 (“Kërkesa”).

<sup>3</sup> Kërkesa, para. 6. Shih F00611/RED, Versioni i Redaktuar Publik i Aktgjykimit, 18 maj 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 18 maj 2022) (“Aktgjykimi”); F00008, Njoftim i Mbrojtjes së Haradinajt për Apelim të Aktgjykimit, 17 qershor 2022 (shpërndarë më 20 qershor 2022) (“Njoftimi i Haradinajt për Apel”).

<sup>4</sup> F00009/RED, Version i Redaktuar Publik i Njoftimit të Gucatit për Apel në lidhje me Aktgjykimin KSC-BC-2020- 07/F00611 (“Aktgjykimi”) në Pajtim me Nenin 46(1)(a), (b) dhe (c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe Rregullën 176(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), 17 qershor 2022 (shpërndarë më 20 qershor 2022; versioni konfidencial u dorëzua më 17 qershor 2022) (“Njoftimi i Gucatit për Apel”).

<sup>5</sup> Njoftimi i Gucatit për Apel, Pika 18.

<sup>6</sup> F00021, Vendim mbi Kërkesën e Haradinajt për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Dosjes së Apelit dhe Kërkesën e ZPS-së për Urdhërimin e Ridorëzimit të Njoftimit të Haradinajt për Apel, 1 korrik 2022 (“Vendimi për Ridorëzimin e Njoftimeve për Apel”), para. 12, 14.

2. Gucati argumenton se numri i fjalëve që kërkohet të shtohen është i vogël dhe është llogaritur si numri “minimal i mundshëm” i fjalëve shtesë të nevojshme për të zëvendësuar Pikën 18 në njoftimin e tij për apel.<sup>7</sup> Sipas tij, pa këtë shtim të numrit të lejuar të fjalëve, ai nuk do të jetë në gjendje të përmbushë udhëzimin e Panelit për ridorëzimin e njoftimit për apel.<sup>8</sup> Ai parashtron më tej se ZPS-ja nuk e kritikoi njoftimin e tij për apel e as Pikat 7, 23, 24 dhe 25 të Njoftimit të Haradinajt për Apel, dhe se numri i lejuar i fjalëve nuk duhet të përdoret për të parandaluar argumentimin e arsyeve për apel përndryshe të lejueshme dhe të hartuara siç duhet.<sup>9</sup>

3. Paneli vëren se neni 47(2) i Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Udhëzuesi i Punës”)<sup>10</sup> parashikon se njoftimi për apel kundër një aktgjykimi të nxjerrë në bazë të nenit 6(2) të Ligjit, sikurse është rasti në çështjen aktuale,<sup>11</sup> nuk duhet të jetë më shumë se 2.000 fjalë. Gjithashtu, neni 36(1) i Udhëzuesit të Punës parashikon se në rrethana të posaçme, pjesëmarrësit mund t’i kërkojnë leje Panelit mjaftueshmërisht në kohë për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve, duke dhënë arsye bindëse për nevojën e tejkalimit të numrit të lejuar të fjalëve.

4. Në lidhje me parashtrimin në kohë të Kërkesës, Paneli vëren se njoftimet e rishikuara për apel priten të parashtrohen më 12 korrik 2022<sup>12</sup> dhe se Gucati parashtrori kërkesën e tij brenda dy ditësh nga nxjerrja e Vendimit për Ridorëzimin e Njoftimeve për Apel. Në këto rrethana, Paneli vlerëson se Kërkesa është parashtruar në kohë.

5. Lidhur me arsyet e vlefshme, Paneli vëren se Gucati kërkon shtim të një numri të vogël fjalësh. Paneli mban gjithashtu parasysh gjatësinë dhe kompleksitetin e

---

<sup>7</sup> Kërkesa, para. 10-11.

<sup>8</sup> Kërkesa, para. 12.

<sup>9</sup> Kërkesa, para. 8-9, 13.

<sup>10</sup> KSC-BD-15, Udhëzuesi i Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019.

<sup>11</sup> Shih Aktgjykimi, para. 10, 65, 1012, 1015.

<sup>12</sup> Shih Vendimin për Ridorëzimin e Njoftimeve për Apel, para. 14. Shih gjithashtu rregullën 9(2) dhe (4) të Rregullores.

aktgjykimit krahasuar me aktgjykime në çështje të tjera në lidhje me vepra penale kundër administrimit të drejtësisë.<sup>13</sup> Megjithatë, Paneli më parë autorizoi shtimin me 800 fjalë të numrit të lejuar të fjalëve të paraparë për njoftimet për apel kundër një aktgjykimi sipas nenit 6(2) të Ligjit.<sup>14</sup> Në këtë aspekt, Paneli rikujton kuadrin e kufizuar të njoftimeve për apel dhe se cilësia dhe efektshmëria e apeleve nuk varet nga gjatësia e tyre, por nga qartësia dhe logjika e argumenteve të paraqitura.<sup>15</sup> Ndërsa Paneli thekson se thelbi i arsyeve për apel duhet të mbetet i pandryshuar në njoftimin e ri për apel,<sup>16</sup> Paneli është i mendimit se nëse dëshiron të mbajë përmbajtjen e Pikës 18, Gucati mund ta ristrukturojë njoftimin e vet për apel ose t'i riformulojë arsyet për apel, për t'i paraqitur argumentet e tij në mënyrë më efikase.<sup>17</sup>

6. Duke u bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se në rrethanat aktuale, kërkesa e Gucatit për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve për ridorëzimin e njoftimit për apel është e papërligjur dhe e panevojshme dhe rrjedhimisht e refuzon kërkesën.

7. Paneli rikujton në fund se, në pajtim me nenin 36(2) të Udhëzuesit të Punës, mocionet për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve mund të miratohen pa u dhënë palëve mundësinë për t'u shprehur në lidhje me mocionin. Duke mbajtur parasysh afatin e ardhshëm për ridorëzimin e njoftimeve për apel dhe duke qenë se ZPS-së nuk do t'i shkaktohet asnjë dëm, Paneli vlerëson se është në interes të drejtësisë që të vendosë menjëherë lidhur me Kërkesën.

---

<sup>13</sup> Shih F00007, Vendim mbi Kërkesën e Haradinajt për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 15 qershor 2022 ("Vendimi për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Njoftimet për Apel"), para. 6; Vendimi për Ridorëzimin e Njoftimeve për Apel, para. 5.

<sup>14</sup> Vendimi për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Njoftimet për Apel, para. 6, 8.

<sup>15</sup> Vendimi për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Njoftimet për Apel, para. 4-5.

<sup>16</sup> Vendimi për Ridorëzimin e Njoftimeve për Apel, para. 11.

<sup>17</sup> Për shembull, kur çështje të caktuara duken të lidhura, ato mund të përmbliidhen në më pak paragrafë. Shih Vendimin për Ridorëzimin e Njoftimeve për Apel, para. 5, që i referohet ICC/GJPN, *Prosecutor v. Ongwen*, ICC-02/04-01/15 A, *Decision on Defence request for a page limit extension for its appeal brief and order setting time limit for responses to the Prosecutor request for extension of time to file her response to the appeal brief*, 8 qershor 2021, para. 15.

8. Për këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

**E REFUZON** Kërkesën.

\_\_\_\_\_/nënshkrimi/\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**Gjykatëse Mishelë Pikar,  
Kryegjykatëse**

E martë, 5 korrik 2022

Në Hagë, Holandë